



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 533/2 Prot.

Tiranë, më 12 / 05 / 2020

V E N D I M

Nr. 45, Datë 12 / 05 / 2020

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 28, datë 24.04.2020, të paraqitur nga F.I kundër Shoqërisë ITX Albania SHPK, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes filozofike” dhe “çdo shkak tjetër¹”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga F.I, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Në datë 15.11.2018 ka filluar punë pranë kompanisë ITX Albania në pozicionin si asistent menaxhere, fillimisht në dyqanin Bershka QTU dhe nga data 01.12.2019 është transferuar në dyqanin Bershka në TEG. Në datë 09.04.2020, nëpërmjet një komunikimi video me zyrën e burimeve njerëzore të kompanisë (M.GJ) është informuar për mos rinovimin e kontratës e cila i përfundonte në datë 14.04.2020,² për arsye të gjendjes së krijuar nga COVID 19 dhe performancës së saj si asistent menaxhere. Ankuesja shprehet se është ndjerë e diskriminuar nga menaxherja e dyqanit R.H, për bindjet e saja filozofike, pasi R.H ndjente shqetësim për marrëdhëniet sociale dhe njerëzore që kishte ndërtuar ankuesja me stafin. Ankuesja informon se është ndjerë e diskriminuar dhe nga procesi i vlerësimit të performancës, të cilës i është nënshtruar vetëm ajo, takim i cili ishte zhvilluar në një mjedis jo të përshtatshëm, me zhurma dhe shumë njerëz (mjedis kafe në TEG)

¹ Pa përcaktuar një cilësi apo shkak.

² Kontratë pune nga data 15.10.2019 deri në datë 14.04.2020, e lidhur mes ankueses dhe shoqërisë ITX Albania.

dhe që kishte zgjatur për rreth 4 orë. Gjithashtu, ankuesja shprehet se është ndjerë e diskriminuar nga menaxherja e dyqanit R.H pasi nuk mund të merrte vendime që i takonin pozicionit të saj të punës, si menaxhere e dytë, sepse nuk ishte e vjetër në kompani prej 5-6 vitesh, siç ishin menaxherët e tjerë dhe përgjegjësja e dyqanit. Ankuesja informon se gjatë ditëve (data 16-20.09.2019) që ishte me leje vjetore i ishte kërkuar nga zyra e burimeve njerëzore që të kryente detyra pune. Ankuesja shprehet se ka kërkuar me shkrim nga zyra e burimeve njerëzore arsyet e mos rinovimit të kontratës por që nuk ka marrë përgjigje”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rikthimin në vendin e punës në dyqanin Bershka QTU.

Pas shqyrtimit paraprak të saj, u konstatua se ankesa e depozituar pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale, lidhur me shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit ankues, në lidhje me shkakun e pretenduar dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

- Për këtë arsye, me e-mail-in datë 28.04.2020, inspektori i çështjes, i ka kërkuar ankueses të paraqesë shpjegime, lidhur me shkakun e pretenduar (bindja filozofike dhe çdo shkak tjetër) dhe shpjegime të trajtimit të pabarabartë në raport me punonjësit e tjerë për shkakun e pretenduar.

Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, ankuesja me e-mail-in datë 28.04.2020 ka dhënë të njëjtat parashtrime që ka bërë të njohura në formularin e ankesës.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të

personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga ankuesja pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi, bindja filozofike dhe çdo shkak tjetër. Ankuesja në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument, indicie apo provë, për të vërtetuar bindjen e saj filozofike. Gjithashtu, ankuesja ka pretenduar se diskriminimi i saj ka ndodhur edhe si pasojë e ndonjë shkakut tjetër por nuk ka identifikuar se cili është ky shkak.

Referuar përmbajtjes së nenit 1 të Ligjit 10221/2010, rezulton tepër e qartë dhe evidente, që të gjitha shkaqet e përmendura, lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me cilësi, apo karakteristika individuale të personave që pretendojnë për diskriminim. Situata diskriminuese në vetvete është gjithmonë e lidhur me një veçori individuale të viktimës dhe në rastin konkret, ankuesja nuk ka identifikuar një shkak të vlefshëm diskriminimi, që të ketë lidhje me një nga karakteristikat e saj personale.

Komisioneri vlerëson se, F.I mund të jetë vënë përpara veprimeve ose mosveprimeve të padrejta të Shoqërisë ITX Albania, por në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkakut të pretenduar nga ankuesja, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së shtetases F.I, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONER

Robert GAJDA